

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria e 8-ta në botë për importet e dronëve ushtarakë, për vitet 2022-2025 - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/shqiperia-e-8-ta-ne-bote-per-importet-e-droneve-ushtarake-per-vitet-2022-2025/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:04:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:03:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	06b7dcce495af567fd3b3821bcee0f86d724b35d8bddae05c0d1dc8c5a91659e
TEKSTI	204635e71210a4ecc0c49d2efcd4a1450b1fde85a91ff6db32b1fa984959c27e
PAMJA	a79d8635fe20b6bcb18a85225b2931e3b972ce3ff5923f092e2a6b9eb58bb2fe

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e9a5c8fd6b0d875ad93e6822076a5ec4c6ca39582c30b6ca8a231e5c83a13fff
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e9a5c8fd6b0d875ad93e6822076a5ec4c6ca39582c30b6ca8a231e5c83a13fff>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Shqipëria e 8-ta në botë për importet e dronëve ushtarakë, për vitet 2022-2025

AKTUALITET

Demo

Shqipëria e 8-ta në botë për importet e dronëve ushtarakë, për vitet 2022-2025

SEPTEMBER 26, 2026



Shqipëria renditet në vendin e 8-të në botë për numrin e dronëve ushtarakë të marrë nga furnizues të huaj gjatë viteve 2022-2025, sipas të dhënave të SIPRI Arms Transfers Database. Në këtë periudhë, vendi ka marrë 56 dronë ushtarakë, ose rreth 0.3% të totalit global prej 16,822 njësisht të regjistruara nga SIPRI.

Brenda rajonit, diferenca është e ndjeshme: Serbia renditet e 21-ta me 10 dronë, pra Shqipëria ka marrë mbi 5 herë më shumë, ndërsa Kosova renditet e 34-ta me 5 dronë, ose mbi 11 herë më pak se Shqipëria. Megjithatë, këto shifra nuk përfshijnë çdo lloj droni ushtarak, pasi SIPRI regjistron kryesisht sistemet e mëdha dhe municionet bredhëse, ndërsa dronët e vegjël FPV dhe një pjesë e madhe e dronëve komerciale të përshtatur për përdorim ushtarak mbeten jashtë statistikave.

Ukraina dhe Rusia marrin mbi 91% të dronëve të regjistruar

Dronët janë kthyer në një prej armëve përcaktuese të luftës moderne dhe tregtia ndërkombëtare e tyre gjatë viteve të fundit është përqendruar pothuajse tërësisht te lufta në Ukrainë.

Sipas të dhënave të SIPRI për periudhën 2022-2025, Ukraina ka marrë nga furnizuesit e huaj 8,664 dronë ushtarakë, duke zënë 51.5% të totalit botëror të regjistruar. Rusia renditet e dyta me 6,720 dronë, ose 39.9% të totalit.

Së bashku, Rusia dhe Ukraina përfaqësojnë mbi 91% të të gjithë importeve të regjistruara të dronëve ushtarakë në këtë periudhë, duke treguar se tregu ndërkombëtar i këtyre sistemeve është dominuar pothuajse plotësisht nga një konflikt i vetëm.

Diferenca me vendet e tjera është shumë e madhe. Asnjë shtet tjetër nuk ka marrë as 300 dronë gjatë kësaj periudhe. Tajvani, në vendin e tretë, ka marrë 291 dronë, Koreja e Jugut 190, Azerbajxhani 154, India 119 dhe Gjeorgjia 100.

Pas tyre vjen Shqipëria me 56 dronë, përpara Hungarisë dhe Lituanisë, që raportohen me nga 50 dronë secila.

83% e dronëve të Ukrainës nga sistemet amerikane

Furnizimet e Ukrainës kanë qenë të përqendruara kryesisht te sistemet amerikane, të cilat përbënin rreth 83% të numrit të regjistruar.

Në rastin e Rusisë, importet e regjistruara nga SIPRI i atribuohen Iranit. Pjesa më e madhe lidhej me dronët Shahed-136, të cilët Rusia fillimisht i importoi nga Irani dhe më pas nisi t'i prodhojë në variantin e saj, të njohur si Geran-2.

Sipas SIPRI, na pak tregues që Rusia të ketë ende nevojë për kontribut të vazhdueshëm iranien për prodhimin e këtyre sistemeve.

Postimet e reja

Shqipëria e 8-ta në botë për importet e dronëve...

SEPTEMBER 26, 2026

Rama takim me komunitetin shqiptar në...

SEPTEMBER 26, 2026

Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit...

SEPTEMBER 26, 2026

"Shtriga" Belinda Balluku/Rexhaj befason me...

SEPTEMBER 26, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç 'Delvina Gas' ai...

ALERT në Slloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

Tregu real i dronëve të vegjël është shumë më i madh

Shifrat e SIPRI japin vetëm një pjesë të aktivitetit real me dronët ushtarakë. Databaza regjistron kategoritë e armëve të mëdha, ku për dronët përfshihen avionët pa pilot me peshë të ngarkuar prej të paktën 150 kilogramësh, si edhe dronët sulmues njëdrejtimësh dhe municionet bredhëse që klasifikohen si raketa.

Dronët e vegjël dhe relativisht të lirë FPV, që përdoren në numër shumë të madh në vijën e frontit, në pjesën më të madhe nuk përfshihen.

Për këtë arsye, diferenca mes statistikave të SIPRI dhe numrit real të dronëve të përdorur mund të jetë shumë e madhe. Vetëm Mbretëria e Bashkuar, për shembull, dërgoi mbi 85,000 dronë të vegjël ushtarakë në Ukrainë gjatë gjashtë muajve të vitit 2025, rreth pesë herë më shumë sesa i gjithë totali global prej 16,822 dronësh që SIPRI regjistron për periudhën katërvjeçare 2022–2025.

Edhe prodhimi vendas mbetet jashtë statistikave të importeve. Industria ukrainase e mbrojtjes ka kapacitet për të prodhuar tashmë mbi 8 milionë dronë FPV në vit, ndërsa inteligjenca ukrainase vlerëson se Rusia prodhon rreth 2,800 dronë Geran-2 në muaj. (Ekofin.al)

2022-2025	aktualitet	armatime	dronë	dronë ushtarakë	forcat e armatosura	importe dronësh
Importet	lajme	Mbrojtja	mbrojtja kombëtare	nato	pajisje mbrojtëse	pajisje ushtarake
Shqipëria në botë	siguri kombëtare	siguria	teknologji ushtarake	tregu i armëve	ushtri	ushtria shqiptare

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu